



Prishtinë, 29 prill 2014
Kodi i ZRRE-së: V_621/2_2014

Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji,

bazuar në:

- Kompetencat e Zyrës së Rregullatorit për Energji (ZRRE) të dhëna në dispozitat e Nenit 14 dhe 25 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë Nr. 03/L-185,
- Dispozitat e Nenit 15 dhe 16 të Licencës së Operatorit të Sistemit të Transmisionit,
- Kërkesën zyrtare për amendamentimin e Standardeve të Sigurisë dhe Planifikimit të Sistemit të Transmisionit dhe Standardeve të Sigurisë së Operimit;

në seancën e mbajtur me 29 prill 2014, nxori këtë:

VENDIM

- I. **Aprovohen** amendamentet në dokumentin *“Standardet e Sigurisë dhe Planifikimit të Sistemit të Transmisionit”*

Arsyetim

- o Komisioni Qeverisës i Kodeve Teknike/Operacionale-KQKO, në takimin e datës 23 Shtator 2013 ka shqyrtuar kërkesën e KOSTT për amendamentimin e dokumenteve *Standardet e Sigurisë dhe Planifikimit të Sistemit të Transmisionit*.
 - o KQKO ka marrë vendim lidhur me propozimet/sugjerimet dhe ka vendos të procedoj kërkesën për aprovim në Zyrën e Rregullatorit për Energji. Kërkesa zyrtare për amendamentimin e *Standardeve të Sigurisë dhe Planifikimit të Sistemit të Transmisionit* është dërguar për aprovim në ZRRE me datë 26.02.2014.
 - o ZRRE pas analizimit dhe komentimit të dokumentit, vlerëson se amendamenti është i arsyeshëm dhe i nevojshëm për t’u përshtatur edhe me ndryshimet e fundit në pronësinë e asetëve, prandaj edhe **aprovon** amendamentet në dokumentin *“Standardet e Sigurisë dhe Planifikimit të Sistemit të Transmisionit”*.
- II Vendimi nxirret në gjuhën shqipe dhe do të përkthehet në gjuhën serbe dhe angleze. Në rast të mospërputhjes midis versioneve, do të mbizotërojë versioni në gjuhën shqipe.
 - III Vendimi hyn në fuqi në datën e miratimit nga Bordi i Zyrës së Rregullatorit dhe do të publikohet në faqen elektronike zyrtare të ZRRE-së.



Këshillë juridike: Kundër këtij vendimi, pala e pakënaqur mund t'i drejtohet Gjykatës Kompetente brenda tridhjetë (30) ditëve nga data e pranimit të Vendimit ose data e publikimit të Vendimit në faqen elektronike të ZRRE-së, cilado që ndodhë e fundit.

Bordi i ZRRE-së

Enver Halimi, kryesues

Merita Kostari, anëtare

Krenar Bujupi, anëtar